

Kur bëhet fjalë për çështjen e sigurisë së pakicave në Kosovë, Policia e Kosovës (PK) është përgjegjëse në thirrjen e parë, EULEX-i në thirrjen e dytë ndërsa KFOR-i në thirrjen e tretë.

Ligji për Policinë (Ligji Nr. 03/L - 035) në nenin 35.4 thotë se "Përbërja etnike e policisë në kuadër të komunës, deri në nivelin e mundshëm, do ta përfaqësojë përbërjen etnike të popullatës të asaj komune."

Për shkak të ngjarjeve të tensionuara në veri të Kosovës dhe braktisjes së pjesëtarëve të etnisë serbe, përbërja etnike në veri nuk është në përputhje me nenin 35.4 të Ligjit për Policinë.



**Në Kosovë janë tetë grupe etnike, shqiptarët si shumicë dhe shtatë të njihura si pakica zyrtare: serbët, boshnjakët, ashkallitë, egjiptianët, goranët dhe romët (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2012)**



Dokumenti strategjik që rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurisë është Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027.



Një nga detyrat kryesore të Komisionit të Sigurisë është të ushtroj kontrollin parlamentar dhe mbikëqyrjen e sundimit të ligjit në institucionet e sektorit të sigurisë.



Komisioni Parlamentar për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes ka anëtarë të përhershëm dhe një vend të garantuar për pjesëtarin e përkatësisë etnike serbe.

Organi politik përgjegjës për çështjet e sigurisë është Komisioni Parlamentar për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes.